

IA
VI
C
R
K
M
1
C
R
K
M
1

C.nr.809/13

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Ardian Ajvazi, në çështjen juridike, sipas padisë së paditëses [REDACTED], dega në Ferizaj Rr. [REDACTED], të cilin me autorizim e përfaqëson [REDACTED], nga Ferizaj, e kundër të paditures [REDACTED] i nga fshati [REDACTED], Komuna e Ferizajt, baza e kontestit mospagimi i kësteve nga kontrata mbi huanë, me datë 01.08.2016 merrë këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses [REDACTED], dega në Ferizaj Rr. [REDACTED] dhe DETYROHET e paditura [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajt, që paditëses në emër të përmbushjes së kontratës së huasë t'ia paguaj borxhin në shumën prej 1,405.61 Euro, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij Aktgjykimi e nën kërkcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m i

Paditësja me datë 18.11.2013 ka parashtruar padi kundër të paditurës për pagimin e borxhit nga kontrata mbi huanë.

Gjykata për këtë çështje juridike civile ka caktuar seancën për shqyrtimin përgaditor të çështjes, mirëpo për shkak të pandërlikueshmërisë së çështjes, nga seanca përgaditore ka kaluar menjëherë në atë kryesorën. Kjo mundësi parashihet edhe në nenin 420.3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore “Gjykata mund të vendosë që seanca për shqyrtim kryesor të çështjes të mbahet menjëherë pas asaj përgaditore”.

Paditësja përmes të autorizuarit të tij ka theksuar se në dhjetor të vitit 2012 e paditura dhe bashkëhuamarrësi i saj kanë nënshkruar kontratën e kredisë (Nr.KOFE-003238-004) me paditësen [REDACTED] dega në Ferizaj në shumën prej 2,000.00 Euro, e cila të paguhet me 24 keste mujore dhe shkallën vjetore të kamatës prej 26.48%. Në seancën e datës 14.07.2016 precizojë kërkesëpadinë në aspektin objektiv dhe në vend të shumës së kërkuar prej 2119 Euro tani kërkojë shumën prej 1405.61 Euro, ngase debitorja defirencën e ka paguar për gjate periudhës së vitit 2014 deri më tani, shuma e mbetur për pagës e të paditurës [REDACTED] është 1,405.61 Euro,

të cilën shumë i propozojë Gjykatës t'a detyron t'a paguaj. Po ashtu hjeti dorë nga kamata ndëshkuese dhe kërkojë vetëm borxhin kryesor.

E paditura nuk ka prezentuar në seancë edhe pse është ftuar me rregull përmes fletëkthesës së datës 18.06.2016 dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, me të njejtën ju ka dorëzuar edhe aktvendimi për përgjigje në padi, në të cilin aktvendim nuk është përgjigjur.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqjese përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, Gjykata ka administruar një sër provash: Marrëveshja për kredi e datës 29.10.2012; Orari i kthimit të kredisë; Letenjoftimi i të paditurës; Vërejtja para padisë e datës 11.07.2012; Njoftimi i datës 08.03.2013; fletëradhitja e pagesave e datës 18.11.2013; fletëradhitja e kështit e datës 14.07.2016.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve dhe provave të lartë cekura, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se padia e paditësit është tërësisht e bazuar.

Pas vlerësimit dhe administrimit të provave Gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-Se e paditura [redacted] si huamarrëse ka marrë kredi në OJQ [redacted] me në shumën prej 2,000.00 Euro me afat të kthimit prej 24 muajve duke filluar nga data 03.12.2012 e deri me datë 03.11.2014;

-Se e paditura ka përmbushur një pjesë të kredisë në shumën prej 760 Euro, kjo shihet edhe përmes orarit të ripagesave, përkatësisht për nëntëmbëdhjetë muaj ka paguaj nga 40 Euro duke fillua nga data 17.10.2014 e deri më 22.06.2016 dhe se shuma për pagesë ka mbetur 1,405.61 Euro, këtë fakt Gjykata e vërtetoi nga raporti i pagesave i datës 14.07.2016;

-Se ekziston baza juridike për përgjegjësi e të paditurës për kthimin e shumës prej 1,405.61 Euro, në bazë të kontratës për kredinë e lidhur me datë 29.10.2012 në mes kredidhënësit [redacted] dhe huamrreses tani e paditur në këtë procedurë [redacted] ti dhe Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Nga faktet e treguara në padinë e paditësit si dhe nga provat dhe shkresat që gjenden në lëndë, rezulton si e themelt tërësisht kërkesëpadija, se gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë kundërshti në mes provave të propozuara dhe fakteve të parashtruara nga paditësja. Gjykata vërtetoi se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për të vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Pjesëmarresit janë të detyruar që në raportet detyrimore të sillen në harmoni me tregun dhe politikën e përcaktuar ekonomike, që të mos e destabilizojnë tregun dhe të mos u sjellin dëm



pjesëmarrësve të tjerë, klientëve. Punët e kryera në kundësttim me parimet e marrëdhënieve të detyrimeve mund të shpallet nuliteti i tyre. Parimi i ndershmërisë dhe i ndërgjegjshmërisë janë dy parime kryesore në të drejtën e detyrimeve dhe palët ndërgjygjëse duhet t'ju përmbahen duke krijuar raporte juridike me mirëbesim. Në nenin 12 të Ligjit mbi Marrëdhënjet Detyrimore parashihet “*Ne themelimin e marrëdhënieve të detyrimeve dhe në realizimin e të drejtave dhe detyrimeve nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit kanë për detyrë t'i përmbahen parimit të ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë*”.

Baza ligjore

Në nenin 557 të LMD-së të vitit 1978 parashihet “*Me kontratën e huasë obligohet huadhënësi t'ia dorëzojë në pronësi, respektivisht në disponim huamarrësit shumën e caktuar të hollash ose sasinë e caktuar të sendeve të tjera të zëvendësueshme, ndërsa huamarrësi obligohet ta kthejë pas një kohe të caktuar të njëjtën shumë të hollash, respektivisht të njëjtën sasi sendesh të llojit dhe të cilësisë së njëjtë*”, në nenin 562 të të njëjtit ligj parashihet “*Huamarrësi ka për detyrë që në afatin e kontraktuar t'i kthejë sendet e marra hua në sasi e në cilësi të njëjtë. Në qoftë se kontraktuesit nuk kanë caktuar, afatin për kthimin e huasë dhe as që ky mund të caktohet nga rrethanat e huasë, huamarrësi ka për detyrë ta kthejë huanë pasi të ketë kaluar afati plotësues, duke filluar që nga kërkesa e huadhënësit që huaja t'i kthehet e që nuk mund të jetë më i shkurtër se dy muaj*”.

Andaj Gjykata duke u bazuar në nenin 143 të Ligjit të procedurës Kontestimore (LPK), neneve 557 dhe 562 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore (LMD 1978) ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.809/13, me datë 01.08.2016



Këshilla Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e nesërme pas pranimit të kopjes së tij, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ / UROŠEVAC



04.10.2016